



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
BORDI

VENDIM  
Nr. 50, datë 24.03.2020

MBI  
SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE, PËR  
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË ERA HYDRO SH.P.K. PËR LICENCIM  
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenit 92 të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë; nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 24.03.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbykqyrjes, lidhur me shtyrjen e afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE, për licencimin e shoqërisë ERA HYDRO sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ERA HYDRO” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 17 Prot, datë 07.01.2020, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Strori”.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 15, datë 23.01.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ERA HYDRO” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Strori”.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/3, datë 27.01.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ERA HYDRO” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 292 Prot., datë 28.01.2020, ERE i’u drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në vijim të kërkesave ka mbërritur e-maili i shoqërisë protokolluar në ERE me nr. 17/1, datë 26.02.2020, nëpërmjet të cilit shoqëria “ERA HYDRO” sh.p.k. ka depozituar “Plotësim dokumentacioni”,
- ERE vlereson se, sa depozituar për shkak të volumit të madh të dokumentacionit për t’u shqyrtuar kërkon kohë përtej afateve të parashikuara në Rregulloren për procedurat dhe

*afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.*

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Shtyrjen e afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE, për licencimin e shoqërisë ERA HYDRO sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me 10 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**